VENDIM
Nr. 58, datë 20.2.2026

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 35, DATË 4.2.2026, "MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHËNË SHOQËRISË 'HEC TRESKA' SHPK ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 80, DATË 24.7.2013"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të neneve 95 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të neneve 7, 8 dhe 9, të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s", Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.2.2026, pasi shqyrtoi relacionin shtesë me nr. 453/2 prot., datë 18.2.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financës , "Mbi përfundimin e procedurave administrative të nisura për heqjen e licencave të shoqërive 'HEC Treska' sh.p.k., 'Hydropower Plant of Korca' sh.p.k. dhe 'Peshku-Picar 1' sh.p.k.".

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 35, datë 4.2.2026, ka vendosur të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "HEC Treska" sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 24.7.2013.
- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare të ERE-s, rezulton se shoqëria e ka shlyer plotësisht debinë e saj brenda afatit 30-ditor të fillimit të procedurës për heqjen e licencës së saj.
- Në nenin 9, germa "a", të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", parashikohet se: "Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8, të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës.".
- Në nenin 95, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", parashikohet se: "Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.".
- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktik, konkretisht shlyerjes së plotë të detyrimit financiar nga ana e shoqërisë. Vërtetimi i pagesës së prapambetur konfirmon se nuk ekzistojnë kushtet që çuan në nisjen e procedurës për heqjen e licencës, pasi objekti për të cilin është nisur kjo procedurë nuk ekziston më.
- Në këto kushte, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2026. Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI**:**

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 35, datë 4.2.2026, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë ‘HEC Treska’ sh.p.k., me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 80, datë 24.7.2013”.

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit nr. 35, datë 4.2.2026.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “HEC Treska” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti